



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 49, datë 28.04.2017**

**PËR**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “BANKA AMERIKANE E INVESTIMIT” SH.A., PËR  
TË VEPRUAR SI KUJDESTAR I OBLIGACIONEVE TË SHOQËRIVE AKSIONARE  
DHE TË QEVERISË VENDORE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 72, pika 6, paragrafi 3 të Ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt”, si dhe nenit 11, pika 1 e Ligjit nr. 10158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e shoqërisë “Banka Amerikane e Investimit” sh.a., për të vepruar si Kujdestar i Obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**